

Nr 367 Prot.



Datë 23/12/2020

VENDIM

I

AKSIONARIT TË VETËM

“EUROSIG” SH.A.

Nr. 11 datë 23/12/2020

Sot më datë 23/12/2020, në selinë e shoqërisë INSIG-JETË sha, në adresën Rr. Labinoti, nr. 77 Tiranë, në prani të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë EUROSIG SH.A., aksionar i vetëm dhe zotërues i 100% të aksioneve të shoqërisë INSIG-JETË sha; Z. Xhevdet Kopani, Drejtor i Përgjithshëm i EUROSIG sha, bazuar në nevojat për kapitale të shoqërisë Insig-Jetë, pas investimi të kryer në blerje Ndërtese të financuar nga institucion krediti në RSH,

VENDOSI:

1. Zmadhimin e kapitalit aksionar të shoqërisë *Insig - Jetë* sha nëpërmjet shtim kapitali me kontribut në natyrë pasuri të paluajtshme-Tokë me vlerë tregu 220,000,000 lek, me të dhënat si vijon:

a. Tokë truall, me sipërfaqe 5,443.7, e ndodhur në adresën Rr. e Durrësit Tiranë, (zona industriale Laprake.

2. Të miratojë ndryshimet që vijnë si rezultat i zmadhim kapitali në natyrë, në vlerën e kapitalit themeltar aksionar të shoqërisë *Insig - Jetë* sha sipas tabelës së mëposhtme, prej nga zmadhimi i kapitalit në natyrë është realizuar nëpërmjet ndryshimit të vlerës nominale për aksion, ndërsa numri i aksioneve mbetet i pandryshuar. Kontributi është i shlyer në natyrë.

Nr	EMËRTIM I	ISHTE			BËHET			VLERA QË SHTOHET
		PËR QIND JA	NUMRI AKSIONEVE	VLERA NË LEK	PËRQI NDJA	NUMR I AKSIONEVE	VLERA NË LEK	
1	EUROSIG SHA	100%	616,000	370,000,000	100%	616,000	590,000,000	220,000,000

3. Autorizohen drejtorët e përgjithshëm të shoqërive Eurosig dhe Insig -Jetë në bashkëpunim, për ndjekjen e procedurave të nevojshme për finalizimin e këtij procesi.

AKSIONARI I VETËM
Shoqëria EUROSIG SH.A.
100 %

Xhevdet KOPANI
Drejtore i Përgjithshëm





VENDIM

I

AKSIONARIT TË VETËM

“EUROSIG” SH.A.

Nr.12 datë 23/12/2020

MBI DISA NDRYSHIME NË STATUTIN E SHOQËRISË SI REZULTAT I ZMADHIMIT TË KAPITALIT AKSIONAR ME KONTRIBUTE NË NATYRË

Sot në Tiranë, më datë 23.12.2020, në selinë e shoqërisë INSIG-JETË sha, në adresën Rr. Labinoti, nr.77 Tiranë, në prani të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë EUROSIG, aksionar i vetëm dhe zotërues i 100% të aksioneve të shoqërisë INSIG-JETË sha; Z. Xhevdet Kopani, Drejtor i Përgjithshëm i EUROSIG sha diskutoi:

- Miratimin e ndryshimeve në statutin e shoqërisë, si rrjedhojë e ndryshimeve në kapitalin e shoqërisë, nëpërmjet zmadhim kapitali me kontribut në natyrë, pasuri të paluajtshme të llojit Tokë-truall.

Në mbështetje të neneve 135 e në vijim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, të statudit të shoqërisë, si dhe në vijim të Vendimit nr.11, datë 23.12.2020 të Aksionarit të Vetëm “Eurosig”, sha, me 100 % të votave,

V E N D O S I :

1. Në statutin e shoqërisë “Insig Jetë” sha, të bëhen këto ndryshime:

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Neni 7”

Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë bëhet 590,000,000 (pesëqind e nëntëdhjet milion) lekë. Ai është i ndarë në 616,000 (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjet mijë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 957.79 (nëntëqind e pesëdhjet e shtatë pikë shtatëdhjet e nëntë) lekë, për çdo aksion.

Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 616,000 përfshirë numrin e fundit të aksionit.

Pjesëmarrja e Eurosig sha në kapitalin themeltar të shoqërisë Insig- Jetë sha është si më poshtë:

NR.	EMËRTIMI	PËRQINDJA	NUMRI I AKSIONEVE	VLERA NË LEKË
1.	EUROSIG SHA-TIRANË	100%	616,000	590,000,000

Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividentit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.

Shoqëria është krijuar dhe funksionon me motiv fitimin, megjithatë në rastet e humbjes, ajo mbulohet gjithashtu proporcionalisht me kontributin themeltar në aksione.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i shoqërisë të ndjekë procedurat e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARI I VETËM

Shoqëria EUROSIG SH.A.

100 %

Xhevdet KOPANI

Drejtor i Përgjithshëm

